

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6978
E premte, 25 gusht 2023
Çmimi 0.40

Vazhdojnë hetimet për avionin e rrëzuar në Rusi, ku besohet se vdiq shefi i Wagnerit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

EMISARËT BËHEN GATI QË NË SHTATOR TË NISË NJË PËRPPJEKJE E RE NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI

FAQE 4-5



Dialogu Kosovë - Serbi pritet të ketë një dinamikë të re në muajin shtator. Emisarët perëndimorë tashmë kanë ndezur motorët për

ta vazhduar punën aty ku e kanë lënë para pushimeve. Ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, ka bërë me dije

se në muajin e ardhshëm do të ketë një përpjekje të re për t'i zgjidhur problemet në mes të Kosovës dhe Serbisë

HOVENIERI DHE KURTI NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE PËR MBROJTJEN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

FAQE 3



KURTI SHËNOI DITËN E PAVARËSISË SË UKRAINËS BASHKË ME QYTETARËT UKRAINAS QË JETOJNË NË KOSOVË

FAQE 5



AKTUALE



COVID-19 ENDE I PRANISHËM, PËR DY JAVË NË KOSOVË U RAPORTUAN 46 RASTE POZITIVE

QEVERIA VAZHDON TË HESHTË PËR PROBLEMET ME UEBFAQET KOMUNALE

PDK-JA, AKSION SIMBOLIK PARA QEVERISË, NË EMËR TË LV-SË HAP KONKURS PËR DILER TË DROGËS

EKONOMI



FALJA E TATIMIT NË PRONË DERI NË 100 EURO, MURATI: KOMUNAT TË VENDOSIN MË SË LARGU DERI MË 15 SHTATOR

BREXIT-i I MBYLL 7 000 VENDE PUNE NGA SISTEMI BANKAR I BRITANISË SË MADHE

SPORT



BALLKANI PARAQET MANAJN

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vazhdojnë hetimet për avionin e rrëzuar në Rusi, ku besohet se vdiq shefi i Wagnerit



MOSKË, 24 GUSHT - Hetuesit vazhduan të kërkonin në rrënojat e një avioni privat që i përkiste grupit Wagner qysh në orët e hershme të mëngjesit së 24 gushtit, pasi ai u rrëzua një ditë më parë gjatë rrugës për në Shën Petersburg nga Moskë, duke mos lënë asnjë të mbijetuar në listën e pasagjerëve. Në ekuipazh besohet se ishte edhe lideri i mercenarëve privatë, Yevgeny Prigozhin, i cili saktësisht dy muaj më parë udhëhoqi një rebelim të shkurtër kundër liderëve të lartë të ushtrisë ruse. Gjurmuesi në internet i fluturimeve, Flightrader24, tregoi një avion brazilian Embraer 600 të regjistruar në emrin e grupit Wagner duke u zhdukur nga radarët herët në mbrëmjen e 23 gushtit. Menjëherë pas kësaj u shfaqën video në rrjete sociale, ku shihet një aeroplan duke rënë nga qielli në një zonë rreth 300 kilometra në veri të Moskës, që përkonte me vendndodhjen e zhdukjes së avionit, raporton Rel. Agjencia Federale për Transportin Ajror të Rusisë (Rosaviatsiya) tha se, "sipas listës së pasagjerëve, emri dhe mbiemri i Yevgeny Prigozhinit ishte" në fluturimin që u rrëzua në veri të Moskës. Zyrtarët e shërbimeve të urgjencës, të cituar nga agjencia shtetërore e lajmeve "RIA Novosti", thanë se trupat e tetë personave ishin gjetur në rrënojat deri më tani, por nuk kishte asnjë informacion nëse ndonjë prej

trupave ishte identifikuar dhe nuk kishte konfirmim se Prigozhini ishte në bord. Komandanti dhe bashkëthemeluesi i Wagnerit, Dmitry Utkin, u rendit gjithashtu në mesin e shtatë pasagjerëve në avion, tha autoriteti i aviacionit, duke cituar linjën ajrore. Dy pilotë dhe një stjuardesë ishin gjithashtu në bordin e avionit, tha autoriteti i aviacionit, duke shtuar se një hetim për incidentin ka nisur. Nuk ka pasur asnjë konfirmim zyrtar nga Kremli apo Ministria e Mbrojtjes se Prigozhini dhe Utkini vdiqën, por një kanal i lidhur me Wagnerin në platformën Telegram e shpalli atë të vdekur. Kanali Gray Zone ("Zona gri" në shqip) e shpalli Prigozhinin një hero dhe një patriot për të cilin tha se kishte vdekur në duart e njerëzve të pidentifikuar që i quajti "tradhtarë të Rusisë". Gray Zone raportoi gjithashtu se një tjetër avion privat në pronësi të Prigozhinit u ul i sigurt në rajonin e Moskës. Një ndërtesë në Shën Petersburg, ku ndodhen zyrat e Wagnerit, ndezi dritat nëpër disa ndërtesa gjatë natës për ta formuar një kryq gjigant, ndërsa disa njerëz u ndalën pranë ndërtesës për të lënë lule dhe për të ndezur qirinj. "Komisioni i Agjencisë Federale të Transportit Ajror po fillon veprimet fillestare në vendngjarje, si dhe ka filluar mbledhjen e materialeve faktike për trajnimin e ekuipazhit, gjendjen teknike të avionit, situatën meteorologjike

në rrugën e fluturimit dhe gjendjen e pajisjeve radio-tokësore", thuhet në një deklaratë të autoritetit të aviacionit. Një aleat i ngushtë i presidentit rus

Vladimir Putin, Prigozhin, udhëhoqi një rebelim jetëshkurtër më 24 qershor, kur luftëtarët e Wagnerit pushtuan qytetin jugor të Rostovmbi-Don dhe marshuan

deri në 200 kilometra larg Moskës. Një avion ushtarak rus u rrëzua gjatë kryengritjes dhe gjithsej 13 trupa të Forcave Ajrore ruse u vranë. Kjo cilësohet si sfida më serioze për Putinin në më shumë se dy dekadat e tij në pushtet. Prigozhini nuk u arrestua apo burgos në atë kohë, por Putini e denoncoi kryengritjen si një "thikë pas shpine" dhe u zotua se do t'i ndëshkojë të gjithë "tradhtarët" e përfshirë. "Nuk ka gjasa që dikush të mendojë se kjo është një rastësi. Thjesht ndodh që kundërshtarët politikë të cilët Vladimir Putini i konsideron si kërcënim për pushtetin e tij nuk vdesin natyrshëm", tha ministri i jashtëm polak Zbigniew Rau. Nëse zbulohet se Prigozhini ka vdekur gjatë fluturimit, kjo do të ishte një goditje e rëndë për grupin Wagner, i cili ishte kyç në betejën e Rusisë për ta marrë qytetin ukrainas të Bakhmut në fillim të këtij viti. Ushtarët e Wagnerit janë të vendosur gjithashtu në Siri, ku Rusia mbështet qeverinë e presidentit Bashar Assad në një luftë civile, dhe në Libi, ku ata luftuan përkrah forcave të komandantit Khalifa Hifter. Grupi ka vepruar gjithashtu në Republikën e Afrikës Qendrore dhe në Mali.

Kush është Wagneri?

Wagneri është një ushtri mercenare ruse që u themelua në vitin 2014, sipas udhëheqësit të saj Yevgeny Prigozhin. Grupi ishte shumë aktiv në luftën në Ukrainë derisa u rebelua kundër ushtrisë ruse në muajin qershor. Luftëtarët e Wagnerit tani raportohet se janë të vendosur në kampet ushtarake në Bjellorusi. Ndërkohë, grupi është aktiv edhe në Afrikë dhe Lindje të Mesme. Vendndodhja e shefit të Wagnerit ka qenë kryesisht një mister që nga rebelimi. Ai u shfaq në videon e tij të parë që nga rebelimi në fillim të kësaj jave. Në videon që besohet të jetë xhiruar në Afrikë dhe të publikuar më 21 gusht në kanalet e Telegramit të lidhura me grupin Wagner, Prigozhini shihet duke qëndruar në një zonë shkretëtire me veshje ushtarake dhe me një pushkë në duar. Më parë ai besohet se po lëvizte nëpër Rusi dhe Bjellorusi, ku trupat e Wagnerit kanë ngritur kampe për t'i trajnuar forcat e armatosura

bjelloruse si pjesë e një marrëveshjeje të negociuar që ndihmoi në përfundimin e rebelimit. Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, tha se ai "nuk ishte i befusuar" nga lajmet se Prigozhini mund të kishte vdekur në rrëzimin e avionit. "Unë nuk e di se çfarë ndodhi faktikisht, por nuk jam i befusuar", tha Biden, duke shtuar se "nuk ka shumë gjëra që ndodhin në Rusi, prapa të cilave nuk është Putini. Por, unë nuk di mjaftueshëm për ta ditur përgjigjur". Kryengritja e Wagnerit erdhi pas disa muajsh konfrontimesh intensive publike me udhëheqjen ushtarake të Rusisë mbi strategjinë e luftës në Ukrainë dhe furnizimet me municione. Kreu i Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (CIA) në Shtetet e Bashkuara, William Burns, tha muajin e kaluar se Putini mund të kërkojë hakmarrje ndaj Prigozhinit. "Putini është apostulli i fundit i shpagimit", tha ai, duke folur më 20 korrik në Forumin e Sigurisë në Aspen. Ai tha se do të habitej

nëse Prigozhini do t'i shpëtonte ndëshkimit të mëtejshëm. "Pra, në këtë kuptim, Bideni ka të drejtë. Po të isha Prigozhin, nuk do ta pushoja nga puna shijuesin tim të ushqimit", shtoi Burns, duke iu referuar një shakaje nga Bideni në fillim të kësaj jave se nëse ai do të ishte Prigozhin, "do të kisha kujdes se çfarë haja". Më herët, më 23 gusht, "RIA Novosti" dhe media të tjera raportuan se gjenerali Sergei Surovikin, një oficer i lartë rus që ka lidhje me Prigozhinin, ishte liruar nga komanda e Forcave Ajrore të Rusisë. Raportet treguan se Surovikin nuk ishte pushuar nga puna, as u degradua, as u burgos siç kishin pritur disa vëzhgues në vazhden e rebelimit të qershorit. Surovikin do të zëvendësohet përkohësisht si komandant i Forcave Ajrore nga gjenerali Viktor Aflazov, sipas "RIA Novosti". Aflazov mbikëqyri forcat ajrore vitin e kaluar kur Surovikin u vu në krye të pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia.

Abdixhiku: Pasaktësia e këtij pushteti sjell në rrezik fillimin e vitit shkollor

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kur ka mbetur edhe një javë nga fillimi i vitit të ri shkollor, vazhdon të mbetet ende sfidë blerja e teksteve shkollore dhe furnizimi i nxënësve me to. Lidhur me situatën e krijuar së fundmi rreth teksteve shkollore, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Ministria e Arsimit do të duhej të ishte e gatshme prej muajsh për ta nisur vitin e ri shkollor. "Një datë është

me rëndësi në arsim. Një shtatori. Në prill do të duhej të nisin përgatitjet që 1 shtatori të nisë mirë", është shprehur Abdixhiku në Klan Kosova FM. "Pasaktësia e këtij pushteti na sjell në rrezik për të bërë një fillim të vitit të ri shkollor", tha ai. Në vend se të flitej për libra në këtë fazë, sipas Abdixhikut, në fushën e arsimit temë do të duhej të ishte digitalizimi. Ministria e

Arsimit nxiti reagime me njoftimin e bërë të hënën se po shqyrtohet mundësia që prindërit t'i blejnë librat shkollorë me mjetet që do t'u deponohen në llogari nga shteti. Ajo e paralajmëroi këtë mundësi pasi tha se nuk ka arritur të lidhë marrëveshje me shtëpitë botuese, duke i akuzuar ato për ofertim të librave me çmime më të larta sesa që ato i shesin në libraritë e tyre.



Kurti shënoi Ditën e Pavarësisë së Ukrainës bashkë me qytetarët ukrainas që jetojnë në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 GUSHT - Në ambientet e Ballkonit të Hapur të Qeverisë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla-Schwarz, kanë mirëpritur të enjten qytetarët ukrainas të strehuar në Kosovë, në mesin e tyre edhe gazetarët ukrainas në kuadër të programit Gazetarët në Rezidencë (Journalists in Residence) të mbështetur nga Qeveria e Kosovës, për ta shënuar bashkërisht Ditën e Pavarësisë së Ukrainës.

Të mbledhur për të përkujtuar këtë moment historik, kryeministri Kurti bashkë me të ftuarit vlerësuan qëndrueshmërinë, vendosmërinë dhe unitetin e popullit ukrainas, të cilët, ndonëse kanë kaluar 32 vjet pas shpalljes së pavarësisë, sot e gjejnë veten përsëri në pozicionin që duhet ta mbrojnë sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të vendit të tyre kundër pushtimit rus.

Në adresimin e tij, kryeministri tha se Republika e Kosovës qëndron plotësisht prapa Ukrainës në këtë mision të shenjtë, duke përmendur së fundmi edhe pjesëmarrjen e Kosovës në Deklaratën e Përbashkët të G7 për Mbështetjen për Ukrainën. "Vetëm këtë javë ne iu bashkuam



Deklaratës së Përbashkët të G7-s për Mbështetjen për Ukrainën. Duke vepruar kështu, ne shprehim gatishmërinë tonë për të kontribuar gjithçka që mundemi për mbrojtjen e Ukrainës në këtë kohë nevojë", tha kryeministri Kurti.

Ai veçoi edhe takimin që pati të hënën në Athinë me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy, teksa u shpreh me shpresë që në takimet e ardhshme të mund të diskutojnë se si Kosova dhe Ukraina mund të punojnë bashkë për

promovimin e vlerave që ndajmë dhe interesave të përbashkëta që kemi.

Bashkë me urimin për Ditën e Pavarësisë, kryeministri Kurti tha se së shpejti të mund të takohemi përsëri, por kësaj radhe për të festuar triumfin e Ukrainës

kundër dhunës, brutalitetit dhe agresionit rus, ndërkohë që tha se jemi krenarë që ju kemi mirëpritur në vendin tonë dhe të lumtur që Kosova është shtëpia juaj e dytë.

Gazetarët ukrainas në këtë takim u shoqëruan edhe nga kryetari i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Xhemajl Rexha dhe përfaqësues të Qendrës Evropiane të Lirisë dhe Shtypit të Medias, drejtori menaxhues Lutz Kinkel dhe Flutura Kusari.

Osmani uron Ukrainën për Ditën e Pavarësisë

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka uruar Ukrainën në Ditën e Pavarësisë. Në platformën "X", Osmani ka thënë se në mes të hijeve të një lufte gjenocidale, shpirti i ukrainasve mbetet i pathyer. "Zemra e një kombi rreh brenda popullit të tij dhe në mes të hijeve të një lufte gjenocidale, shpirti i ukrainasve mbetet i pathyer. Nga një tokë e forcës, demokracisë dhe shpresës në tjetrën, i urojmë popullit të guximshëm të Ukrainës gëzuar Ditën e Pavarësisë!", ka shkruar Osmani.

Në Deçan u mbajt mbledhje përkujtimore në nderim të jetës dhe veprës së aktorit të madh Xhevat Qorraj

DEÇAN, 24 GUSHT - Të enjten në komunën e Deçanit është mbajtur mbledhje përkujtimore në nderim të jetës dhe veprës së artistit të madh të kinematografisë shqiptare dhe teatrore, Xhevat Qorraj, i cili ka ndërruar jetë të mërkurën në moshën 78-vjeçare. "Jeta dhe veprimtaria e tij prej artisti, e njeriu të talentuar e punëtor do të jetë frymëzim e shembull për breza të tërë. Do ta kujtojmë

përjetësisht përmes roleve të tij të shumta në teatër dhe film dhe trashëgimisë që la pas në kulturën dhe artin tonë kombëtar", ka thënë në fjalën e tij kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj. Ai ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta për familjen Qorraj, komunitetin artistik, kolegët, miqtë dhe të gjithë ata që e njohën! "Shpirti i tij u prehtë në paqe!", ka thënë Ramosaj. Rolet e tij në teatër dhe film do

të mbahen mend gjatë dhe do të vazhdojnë ta ndriçojnë rrugën e artit për shumë gjenerata.

Teatri Kombëtar i Kosovës ka kujtuar Xhevat Qorrajn për talentin e tij të rrallë, rolet e tij të shumta, kolegialitetin e tij të pashoq dhe kontributin e tij të pafund në kulturën dhe artin tonë kombëtar. Xhevat Qorraj është varrosur të enjten në vendlindjen e tij në fshatin Carrabreg i Ulët.





Emisarët bëhen gati që në shtator të nisë një përpjekje e re në dialogun Kosovë - Serbi

Dialogu Kosovë - Serbi pritet të ketë një dinamikë të re në muajin shtator. Emisarët perëndimorë tashmë kanë ndezur motorët për ta vazhduar punën aty ku e kanë lënë para pushimeve. Ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, ka bërë me dije se në muajin e ardhshëm do të ketë një përpjekje të re për t'i zgjidhur problemet në mes të Kosovës dhe Serbisë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 GUSHT - I dërguari evropian për bisedimet Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka njoftuar një ditë më parë se me të dërguarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka diskutuar në Bruksel për çështjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, gjendjen aktuale dhe rrugën përpara, si dhe për çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor. Njoftimi u bë në një periudhë kur Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara presin që Kosova dhe Serbia ta shtensionojnë situatën në veri të Kosovës në mënyrë që të hapet rruga për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat me shumicë serbe.

Qeveria e Kosovës është pajtuar për të mbajtur zgjedhje të reja në veri të vendit dhe është vënë në punë për hartimin e një

dokumenti, nëpërmjet të cilit pritet të përcaktohen rregullat se si të organizohet një peticion që do t'u mundësonte qytetarëve të komunave shkarkimin e kryetarëve shqiptarë që nuk pranohen prej tyre. Për të pasur sukses peticioni, sipas zyrtarëve të qeverisë, ai duhet ta shprehë vullnetin e 20 për qind të votuesve të një komune.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se Kosova është duke zbatuar me përpikëri pajtimin e arritur në Bratisllavë në muajin korrik për shtensionimin e situatës në veri të vendit. "Kanë kaluar dy muaj prej kur është regjistruar incidenti i fundit serioz, edhe më gjatë prej kur ka pasur protesta të dhunshme. Tani duhet parandaluar rieskalimi. Kur s'ka protesta të dhunshme të planifikuara, të organizuara nga Beogradi zyrtar, nuk ka eskalim në veriun e Kosovës", ka thënë ai. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka bërë me dije se do të

takohet me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës për shkak të, siç ka thënë, trysnisë së madhe me të cilën po përballen dhe vazhdimin të provokimeve nga kryeministri Albin Kurti. Ai paralajmëroi se së shpejti Serbia do të kërkojë një seancë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për shkak të ngjarjeve të fundit në Kosovë. Ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, ka thënë në një intervistë për "Zërin e Amerikës", se pret përpjekje të reja në shtator për zgjidhjen e krizës në veri të Kosovës. "Unë besoj se kjo çështje është urgjente dhe se duhet të ketë një përparim në këtë çështje. Mendoj se të paktën ne e dimë se cilët janë përbërësit për një lloj të ardhmeje të qetë. Është shumë e qartë se ne kemi nevojë për një asociacion të komunave serbe. Është e qartë se Kosova ka nevojë për qasje më të mirë në strukturat ndërkombëtare.

Kështu që mendoj se ne në thelb e dimë se çfarë do të përpiqemi të bëjmë. Problemi është t'i bashkohim të gjitha. Është si një mozaik i madh. E hedh në tavolinë, pastaj duhet ta bashkohim. Nuk është e lehtë", ka thënë Hill.

Shtensionimi i situatës në veri dhe kthimi në dialog janë kërkesa edhe të shteteve perëndimore ndaj Kosovës. Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, gjatë një bisede me gazetarët në Prishtinë më 16 gusht, tha se kërkesat e vendit të tij ndaj Qeverisë së Kosovës nuk kanë të bëjnë me presion. Ai tha se vendi, megjithatë, nuk do të mund t'i vazhdojë proceset integruese pa bërë përparim në dialogun me Serbinë. "Kosova nuk do të mund të bëhet anëtare e BE-së; Kosova nuk do të jetë në gjendje ta tejkalojë Partneritetin për Paqe për t'u bërë anëtare e NATO-s - dy synimet themelore që ShBA-ja pret që ajo t'i realizojë - pa bërë përparim në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Prandaj, kërkojmë nga Kosova që tash për tash ta zbatojë marrëveshjen e Ohrit. Të lëvizë shpejt, qëllimisht, për t'i çuar përpara negociatat për të krijuar një asociacion të komunave me

shumicë serbe", ka thënë Hovenieri.

Hovenieri ka pohuar se mbajtja e zgjedhjeve në katër komunat veriore të banuara me shumicë serbe është një nga pikat që është identifikuar nga BE-ja si diçka që mund ta shtensionojë situatën në këtë pjesë të vendit dhe se ShBA-ja pajtohet me këtë kërkesë. "Jemi të shqetësuar sa i përket situatës në veri të Kosovës dhe i kemi kërkuar qeverisë të marrë masa. I kemi kërkuar edhe Qeverisë së Serbisë të marrë masa për ta arritur shtensionimin në veri të Kosovës. Ne duam të shmangim trazira, kërcënime të dhunës dhe gjëra të tjera të cilat pengojnë aftësinë tonë për të punuar me palët për t'u fokusuar në objektivat strategjike, që është zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit, nga të dyja palët", ka deklaruar ai.

Hovenieri ka shtuar se Kosova është zotuar se do t'i përmbushë pikat e rena dakord në mes të kryenegociatorit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe emisarit evropian Miroslav Lajçak, në Bratisllavë, për shtensionimin e situatës në veri, dhe se ShBA-ja e mirëpret dhe e sheh këtë si hap pozitiv drejt shtensionimit.

PDK-ja, aksion simbolik para qeverisë, në emër të LV-së hap konkurs për diler të drogës

Prishtinë, 24 gusht - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) përmes një aksioni simbolik ka reaguar përsëri për aferën "Droga", në të cilën ishte i përfshirë asamblisti i Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, Besnik Mujeci, i cili javën e kaluar u arrestua si pjesë e një grupi kontrabandues në Shqipëri, pasi iu zunë mbi 11 mijë e 300 doza drogë, që kapin shumën rreth gjysmë milioni euro.

Rinia e PDK-së ka vendosur një baner para Qeverisë së Kosovës me mbishkrimin "Konkurs për diler të drogës". Kryetari i Rinisë Demokratike të Kosovës në Prishtinë, Trim Sylja, ka thënë se sot, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, po e shpallin këtë konkurs. "Siç e dini, asamblisti i kësaj partie është zënë me drogë, me 11 300 doza

ekstazi, prandaj e kuptojmë që kanë mbetur keq për shpërndarës të drogës brenda dhe jashtë Kosovës", theksoi ai. Sylja tha se qeveria Kurti mund të mos ketë libra dhe bukë për qytetarët, po drogë ka me bollëk. "Sot, kur po flasim, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nga mbi 1.2 milion qytetarë në moshë pune, mbi 77 mijë janë të papunë dhe mbi 750 mijë janë ekonomikisht joaktivë. Ndërkaq, rreth 100 mijë të rinj e kanë lëshuar vendin në dy vitet e fundit. As nuk po mund ta paramendojmë edhe sa të tjerë do të ikin nga janari. Përdorimi dhe shpërndarja e drogës nga partia në pushtet po i ndihmon edhe njëzërisht edhe tjetër. Kjo qeveri ndoshta libra dhe bukë nuk ka, po drogë ka sa të duash", ka thënë ai.



Departamenti i Shtetit e vlerëson të papranueshëm presionin ndaj policëve serbë në veri të Kosovës

PRISHTINË, 24 GUSHT - Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) ka shprehur brengosje të thellë për dorëheqjet e fundit të policëve të porsaemëruar serbë në veri të Kosovës si pasojë e presionit, dhe ka thënë se është e papranueshme që "dikush, përfshirë edhe aktorët e lidhur me Serbinë, të ushtrojë presion politik ndaj individëve që duan t'i bashkohen" Policisë së Kosovës. "Policia e Kosovës ofron shërbime jetike për të gjitha komunitetet dhe qytetarët e Kosovës. Ne dënojmë çdo përpjekje për ta minuar diversitetin brenda radhëve të saj", tha një zëdhënës i Departamentit të Shtetit për "Radion Evropa e



Lirë" më 23 gusht.

Departamenti i Shtetit u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë të kthehen në dialog për normalizimin e marrëdhënieve. Së paku shtatë policë serbë kanë dhënë dorëheqje nga

Policia e Kosovës që nga java e kaluar, gjë për të cilën autoritetet e Kosovës e fajësuan Beogradin zyrtar.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, deklaroi më 18 gusht se "tashmë ka informacione të

konfirmuara se kërcënimet dhe shantazhet vijnë nga Serbia". Beogradi zyrtar nuk i ka komentuar këto akuza. Dyzet e gjashtë policë të rinj serbë e nisën punën në veri të Kosovës në fund të korrikut, por ata u përballën menjëherë me kërcënime online në rrjetet sociale, të cilat zyrtarët e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare i kanë dënuar ashpër.

Rreth 550 policë serbë në veri - në komunat Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok - patën dhënë dorëheqje kolektivisht nga Policia e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar si shenjë proteste ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e makinave me

targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës.

Pas dorëheqjeve, autoritetet në Kosovë patën shpallur konkurs për praninë të policëve të rinj, duke i punësuar 74 të tillë. Prej tyre, 46 është raportuar se kanë qenë nga komuniteti serb. Integritimin e serbëve në Policinë e Kosovës e parasheh një marrëveshje e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel më 2013, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Dy vendet janë pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, për normalizim të raporteve, prej vitit 2011.

Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

Hovenieri e Kurti nënshkruajnë marrëveshje për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar

PRISHTINË, 24 GUSHT - Qeveria e Kosovës dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë nënshkruar të enjten marrëveshje mbi masat e sigurisë me qëllim të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar. Marrëveshja është nënshkruar nga ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier dhe kryeministri Albin Kurti. Me këtë rast, kryeministri Kurti ka thënë se marrëveshja parasheh veprimet e të dyja palëve në raport me informacionin e humbur, mënyrën e asgjësimit të informacionit të klasifikuar, të ndarjes së tij në raport me palët e autorizuar. "Koncepti i sigurisë kombëtare është udhërrëfyes i qeverisjes së

përgjithshme. Qeveria e ka për detyrë të sigurohet që qytetarët janë të mbrojtur, dhe një gjë e tillë e bën përmes veprimeve të mençura politike, ekonomike, diplomatike dhe ushtarake", ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se siguria kombëtare është e drejtë dhe nevojë. "Ajo përkthehet në vullnetin dhe obligimin e qeverisë që të marrë vendime me të cilat garanton pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit, detyrë kjo e cila kërkon jo rrallë ruajtjen e informacionit si konfidencial. Mbrojtja e atillë e informacionit parashihet me ligj dhe siguron mbrojtje përderisa interesi kombëtar dikton një gjë të tillë. Prandaj



sot, së bashku me ambasadorin Hovenier, u pajtuam që informacioni i kategorizuar si i tillë do të

ruhet ashtu siç e parasheh legjislacioni nacional dhe nuk do të zbulohet përveç atyre që kanë certifikatë të sigurisë, pa

marrë parasysh pozitën apo titullin që personi i interesuar në informacion të klasifikuar gëzon", ka deklaruar Kurti.

Totaj falënderon qytetarët për bashkëpunim me institucionet e sigurisë

PRIZREN, 24 GUSHT - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i kryesuar nga kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka mbajtur mbledhjen e radhës në sallën e kuvendit të komunës. Totaj i falënderoi banorët e kësaj komune për qytetari aktive dhe bashkëpunim me të gjitha institucionet e sigurisë në

Prizren. Gjatë këtij takimi u bë vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Prizrenit gjatë sezonit korrik-gusht; shqyrtimi i draft-planit të fizibilitetit për vendosjen e kamerave në Prizren; raportimi i DKA-së për përfundimin e vitit shkollor 2022/2023; u diskutua mbi nivelin e sigurisë

në fillim të vitit shkollor dhe zbatimin e planit për siguri në shkollat e komunës së Prizrenit; prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm; identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta si dhe raportimi e parandalimi i dhunës në familje.



Komuna e Mitrovicës subvencionon edhe 114 qytetarë për shpenzimet me barna dhe trajtime mjekësore



MITROVICË, 24 GUSHT - Drejtoria për Shëndetësi në Komunën e Mitrovicës ka realizuar mbështetjen financiare për shpenzime me barna dhe trajtime mjekësore për të gjithë qytetarët që kanë aplikuar gjatë muajit maj. Gjithsej janë subvencionuar 114 qytetarë, duke pasur prioritet të sëmundjeve me sëmundje kanceroze. Shuma totale ka arritur në vlerë prej 16 000.00 eurosh. Kjo është faza e katërt e subvencionimit pasi që në fazën e parë, të dytë dhe të tretë janë subvencionuar të gjithë qytetarët që kanë aplikuar gjatë muajve janar, shkurt, mars dhe prill 2023. Deri tash gjatë vitit 2023 komuna e Mitrovicës ka subvencionuar

gjithsej 949 qytetarë në shumën 122 750.00 euro.

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Fahri Shabani, ka deklaruar se subvencionimi i qytetarëve do të vazhdojë edhe në muajt në vazhdim. Prioritet janë qytetarët me sëmundje kronike dhe me sëmundje kanceroze e të cilët ndodhen në kushte jo të mira ekonomike. "Drejtoria për Shëndetësi mbetet e përkushtuar në punën dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm për përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve", ka thënë ai. Këto mjete janë siguruar nga buxheti i komunës së Mitrovicës, konkretisht nga të hyrat vetjake.

Tregu i veturave dhe autoshkollat do të vendosen në lokacion të ri në Prishtinë

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar për fillimin e punimeve në rregullimin e infrastrukturës në kryeqytet. Ai ka bërë me dije se së shpejti do të funksionalizohet parkingu i madh në hyrje të Prishtinës. Po ashtu, tregu i drunjve dhe lëndëve të tjera djegëse, sepse nuk do të lejohen më tutje që këto produkte të shiten në zonën urbane, përkatësisht në zona të banimit në kryeqytet. "Tregu i veturave nuk do të jetë më në Zonën Industriale në Fushë-Kosovë, por do ta zhvendosim pikërisht në këtë lokacion ku kemi filluar

punimet, në Kodrën e Trimave. Autoshkollat do ta kenë lokacionin e veçantë. Ato do të zhvendosen nga 'Stacioni i Autobusëve' në lokacionin i cili do të rregullohet në Kodrën e Trimave", ka shkruar Rama në "Facebook". Sipas tij, komunikacioni do të ketë shumë lehtësime me përmbylljen e këtij projekti. "Së bashku me drejtorin e Investimeve Kapitale, Krenar Xh. Xhaferi dhe drejtorin e Inspektoratit të Kryeqytetit, Florian Dushi, vizitua punimet të cilat tashmë vetëm se kanë filluar realizimin e këtij projekti të madh", ka njoftuar Rama.



22 familje në Podujevë bëhen me shtëpi të reja

PODUJEVË, 24 GUSHT - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me humanistin Elvis Naçi, përfaqësues të familjes Stublla, përfaqësues të Shoqatës "Shqiptarët për shqiptarët" dhe kolegë të ekzekutivit komunal, dhuruan çelësat e shtëpive të banimit për 22 familje llapjane me gjendje të rëndë ekonomike.

Ndërtimi i shtëpive u realizua nga bashkëpunimi në mes të komunës dhe Shoqatës "Shqiptarët për shqiptarët", ku shoqata ka investuar në ndërtimin dhe kompletimin e shtëpive të banimit, kurse komuna në infrastrukturën nëntokësore dhe mbitokësore të lagjes. Shtëpitë e banimit janë të kompletuara dhe me kushte shumë cilësore për banim

për familjet përfituese. Kryetari Bulliqi falënderoi për zemërsisht hoqhën Elvis Naçi dhe Shoqatën "Shqiptarët për shqiptarët", familjen Stublla për dhurimin e tokës për ndërtimin e lagjes, Sylejman Rrahmanin që ka kontribuar që ky investim të bëhet në Podujevë si dhe gjithë të tjerët që kanë kontribuar për ndërtimin e shtëpive.



Covid-19 ende i pranishëm, për dy javë në Kosovë u raportuan 46 raste pozitive

Prishtinë, 24 gusht - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se në dy javët e fundit janë raportuar 46 raste pozitive dhe asnjë rast i vdekjes me Covid-19. Sipas grup-moshave, rezulton se numri më i madh i rasteve i takojnë grup-moshave 40-49 vjeç (me 15 raste) me moshë mesatare 43

vjeç. Prej rasteve të konfirmuara, sipas komunave, rezulton se numri më i madh është raportuar nga komuna e Prishtinës dhe Kamenicës (me nga 14 raste), kurse incidenca më e lartë e rasteve në 100 000 banorë është raportuar në komunën e Kamenicës. "Përkundër rasteve të

shënuara së fundi, situata epidemiologjike në Republikën e Kosovës me Covid-19 mbetet e qetë, ndërsa qytetarët që manifestojnë shenja të infeksionit këshillohen të testohen dhe konsultohen me mjekun për çdo dyshim në Covid-19", ka njoftuar IKShPK-ja.



Qeveria vazhdon të heshtë për problemet me uebfaqet komunale

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 GUSHT- "Komunat e Kosovës po hyjnë në vitin e dytë që kanë probleme të theksuara me uebfaqet zyrtare. Madje është java e dytë që uebfaqet nuk janë duke funksionuar fare në publikimin e dokumenteve, çka është duke i penalizuar komunat që janë duke raportuar në platformën interne të Grantit të Performancës", ka njoftuar Asociacioni i Komunave i Kosovës.

Në njoftim thuhet se këto shqetësime Kolegjiumi i Zyrtarëve për Komunikim me Publikun në Komuna i ka paraqitur disa herë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, por ende nuk është bërë asnjë zgjidhje dhe komunat janë duke marrë barrën e dështimit, pa fajin e tyre. "Komunat vazhdimisht janë duke u ballafaquar me probleme në mosfunksionimin

e uebfaqeve, madje ka pasur raste kur në mosfunksionimin e tyre kanë humbur pjesa më e madhe e dokumenteve dhe është e vështirë të identifikohen dokumentet e humbura. Shumica e indikatorëve në Grantin e Performancës që matin transparencën komunale kanë të bëjnë me afatet ligjore të publikimit të dokumenteve të ndryshme", thuhet në njoftim. Më tej theksohet se zyrtarët për Komunikim me Publikun në Komuna janë duke shqyrtuar mundësinë të mos raportojnë fare në platformën e Grantit të Performancës për vitin 2022 pasi të gjitha penalizohen për shkak se shumica e indikatorëve në këtë Grant kanë të bëjnë me publikimin e dokumenteve. Po ashtu, komunat janë duke u penalizuar jo vetëm në matjen për Grantin e Performancës nga MAPL, por edhe në të gjitha matjet e OJQ-ve, nga auditorët e jashtëm, qytetarët, mediet dhe në secilin dimension tjetër që ka të bëjë me transparencën komunale. "Ky është viti i dytë



kur zyrtarët e ngarkuar për publikimin e dokumenteve kanë tejet vështirësi dhe shumë herë edhe nuk janë funksionale uebfaqet, ndërsa qeveria asnjëherë nuk është marrë me këtë problem përkundër që është nën menaxhimin e saj. Zyrtarët e ngarkuar për publikimin e dokumenteve kanë përgjegjshmëri të lartë në mirëmbajtjen e tyre dhe falë

përkushtimit të tyre, shumica e komunave në vlerësimet që iu bëhen, sikurse nga niveli qendror për grant të performancës, ashtu edhe nga shoqëria civile e mediet, kanë avancim shumë të theksuar në transparencë, sidomos pas unifikimit të uebfaqeve me programin WordPress, por tani pa fajin e tyre, komunat në Republikën e Kosovës do të

penalizohen në matjen e performancës. Këto shqetësime ka kohë që janë ngritur nga Kolegjiumi për Komunikim me Publikun dhe Kolegjiumin e Zyrtarëve Komunalë të IT-ve në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, por deri më tani nuk është hetuar ndonjë vullnet nga niveli qendror për ta zgjidhur këtë problem", ka njoftuar AKK-ja.

Një pacient i vdekur, pesë të lënduar nga një zjarr në QKUK



PRISHTINË, 24 GUSHT - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka konfirmuar më 24 gusht se një pacient ka vdekur shkak i një zjarri në njërën nga dhomat në Repartin e Urgjencës dhe Intensives Psikiatrike të këtij institucioni një natë më parë. Sipas njoftimit të QKUK-së, zjarri, që la një person të vdekur dhe pesë të lënduar, nisi të mërkurën rreth orës 23:00 në një dhomë të tipit të mbyllur,

ku qëndrojnë përkohësisht pacientët që bëhen agresivë dhe humbin vetëdijen. "Dyshohet se një pacient i ka vënë zjarrin në rrethana të panjohura dhomës së tipit të mbyllur me ç'rast, si pasojë e ngufatjes nga tymi (asfiksioni), ai ka humbur jetën, përkundër përpjekjeve maksimale të stafit shëndetësor për ta shpëtuar pacientin", thuhet në njoftimin e QKUK-së. Më tutje, në këtë njoftim bëhet

me dije se shenja të helmimit nga tymi kanë shfaqur edhe pesë persona në këtë klinikë - një paciente, dy mjekë dhe dy infermierë. Këta të fundit, siç thuhet në komunikatën e QKUK-së, u lënduan "gjatë ofrimit të ndihmës për pacientin në fjalë dhe evakuimit të pacientëve të tjerë". QKUK-ja ka bërë me dije se tashmë rasti është duke u hetuar nga njësitet përkatëse të Policisë së Kosovës.

Vazhdojnë pritjet e gjata në Merdar dhe te Dheu i Bardhë

Prishtinë, 24 gusht - Pikat kufitare me Serbinë, Dheu i Bardhë dhe Merdar, edhe të enjten kanë qenë të ngarkuara nga fluksi i bashkëdhetarëve të cilët po i përdorin për hyrje dhe dalje nga territori i

Kosovës. Sipas Qendrës Kombëtare për Menaxhimin Kufitar (raporti i orës 00:15), plot tri orë nevojiten për ta lëshuar Kosovën përmes vendkalimit kufitar të Merdarit, ndërsa kolona

është deri në 800 metra. Edhe në pikë kalimin te Dheu i Bardhë pritjet janë mbi një orë dhe kolona është 500 metra. Në vendkalimet e tjera kufitare të Kosovës nuk ka pritje të gjata.



Kosova në kampanjën e EFSA-s për ta parandaluar përhapjen e Murtajës Afrikane të Derrave

PRISHTINË, 24 GUSHT - Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore (EFSA) përmes fushatës "StopASF" po rritë ndërgjegjësimin e fermerëve, gjuetarëve dhe veterinerëve për ta parandaluar përhapjen e Murtajës Afrikane të Derrave. Përmes kampanjës StopASF mëtohet të informohen fermerët, veterinerët dhe gjuetarët që të "identifikojnë,

parandalojnë dhe raportojnë" rastet e ASF-së të cilat mund të lajmërohen te derrat të cilët kultivohen në amvisëri, si dhe te derrat e egër. Format e parandalimit, kufizimin e shtrirjes së rasteve të lajmëruara dhe, para së gjithash, identifikimin e simptomave mund t'i gjeni në materialin promovues.

Si agjenci e BE-së, EFSA i nënshtrohet Rregullores (BE) 2018/1725, e cila ka vlerë të barabartë ligjore si Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (BE) 2016/679 (GDPR) e zbatueshme në shtetet anëtare të BE-së dhe e cila është në përputhje me rregullat dhe parimet e GDPR-së për mbrojtjen e të dhënave personale.



Falja e tatimit në pronë deri në 100 euro, Murati: Komunitat të vendosin më së largu deri më 15 shtator

PRISHTINË, 24 GUSHT - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se Ligji i ndryshuar për Tatimin në Pronë tashmë është në fuqi pas votimit në Kuvend dhe dekretimit nga presidentja. Përmes këtij ligji ai ka thënë se mundësohet falja e faturave të tatimit në pronë deri në 100 euro për secilin tatimpagues dhe ka bërë me dije se komunitat duhet të vendosin më së largu deri më 15 shtator për këtë zbritje. "Pra, të gjitha komunitat do ta kenë mundësinë ta zvogëlojnë barrën tatimore për qytetarët ashtu siç kanë kërkuar dhe, kështu, t'i kursejnë shumicën prej tyre nga pagesa e kështit të dytë që duhet të bëhet muajin shtator", ka shkruar Murati në "Facebook". Në rast miratimi nga komuna, ministri ka sqaruar se qytetarëve që tashmë kanë paguar faturën e tatimit në pronë, shumica e paguar u llogaritet parapagim



për faturën vijuese. Lidhur me faljen e 100 eurove të tatimit në pronë, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka paralajmëruar se ky ligj të dërgohet në Gjykatën

Kushtetuese për interpretim. Sipas AKK-së, komunitat me miratimin e këtij ligji në Kuvendin e Kosovës do të humbasin dhjetëra miliona euro dhe miratimi i tij pa konsulta paraprake me

komunitat e ka cenuar autonominë lokale financiare. "Duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës, ku thuhet se palët e autorizuar për ngritjen e rasteve në gjykatë janë edhe komunitat,

atëherë Bordi i AKK-së, duke marrë parasysh që komuna si institucion shtetëror është e autorizuar ta kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve dhe akteve ligjore, u rekomandon komunave ta dërgojnë këtë ligj në Gjykatën Kushtetuese për interpretim kushtetues", thuhet në reagimin e AKK-së. Rritja e faturave të tatimit në pronë ka ndodhur pas vlerësimit të përgjithshëm të tokave dhe objekteve rezidenciale që ka bërë MF-ja në fund të vitit të kaluar. Pas këtij vlerësimi, tatimi në pronë për disa është rritur deri në 100 për qind e për disa ka mbetur i pandryshuar, pasi vlera e pronës pas vlerësimit nuk ka ndryshuar. Partitë opozitare në Kuvendin e Kosovës e kanë kundërshtuar rritjen e tatimit në pronë. Nga tatimi në pronë buxheti i Kosovës ka të hyra vjetore deri në 40 milionë euro.

BREXIT-i i mbyll 7 mijë vende pune nga sistemi bankar i Britanisë së Madhe

LONDËR, 24 GUSHT - Roli i Londrës si "Mbreti i Evropës" për ofrimin e shërbimeve financiare pas BREXIT-it duket se është nën presionin e Parisit, Frankfurtit dhe Dublinit. Megjithatë parashikimet për një eksod prej një çerek milioni vende pune nga Londra pas ndarjes me Brukselin nuk janë realizuar, një raport i ri tregon se janë mbyllur mbi 7 000 vende pune nga Britania e Madhe. Derisa mund të mos ketë pasur ndryshime me shumicë në tregjet financiare të Evropës, disa ekspertë besojnë se sektorë të veçantë po riorganizohen dhe rikalibrohen. "Londra ende shihet si një lojtarë financiare



botërore, por nuk është qendra e vetme evropiane e shërbimeve financiare dhe

mendoj se kjo është ajo që ka ndryshuar si rezultat i BREXIT-it", thotë David Henig, i cili

punon me Qendrën Evropiane për Ekonominë Politike Ndërkombëtare. "Tani njerëzit

mendojnë se nuk është vetëm Londra që është një qendër financiare evropiane, por edhe vende të tjera. Mund të jetë Parisi ose Amsterdam. Mund të jetë Dublini", shton ai. Ish-kryekonomisti i Bursës Gjermane, Peter Lawlor, beson se BREXIT-i ka pasur padyshim një efekt të dëmshëm në pasuritë e Londrës, por shtoi se është shumë herët për ta parashikuar të ardhmen. "Unë nuk mendoj se të menduarit strategjik është bërë siç duhet në Britani të Madhe. Frankforti ishte i etur, Parisi po ashtu ishte shumë i etur. Ju dini për stimujt e paraqitur në qytete të ndryshme evropiane", thekson Lawlor.

Peci nënkruam vendimin për lirim të pronës së Institutit Bujqësor të Kosovës në Prishtinë

Prishtinë, 24 gusht - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka njoftuar se ka nënkruar vendim për lirim të pronës

së Institutit për Hulumtime Shkencore në Bujqësi që ndodhet në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë. Peci për këtë pronë ka thënë

se është bërë tjetërsim dhe bartje e pronës nga shtetërore në private. "Për këtë objekt kam nënkruar vendimin për lirim të pronës

shtetërore të uzurpuar, veprim administrativ ky i mbështetur në bazë ligjore", ka bërë me dije Peci në "Facebook".



Jeta dhe fati (i paralajmëruar) i kuzhinierit të Carit

E vetëm sot kuptohet se sa dëshpërim kishte në atë gjest ekstrem.

Sepse nëse do të kishte një person që e njihje mirë presidentin rus, ishte ai, ish i dënuari dhe ish-shitësi i hot dog-ëve, i cili u rrit gjithashtu në rrugicat e Shën Petersburgut kaq të rëndësishëm për formimin personal të Carit, të cilit i detyrohej gjithçka. Prandaj ai e dinte se kishte njëfarë të vërtete në atë që vëzhguesit rusë dhe perëndimorë pohuan në unison, në marrëveshje, secili me formula të ndryshme, duke i dhënë atij edhe pak kohë në liri ose në jetë. Mediat më të afërta me Kremlinin bënë thirrje për “dënime shembullore”, emisionet propagandistike të cilat disa muaj më parë lavdëronin “pushtuesin e Bakhmutit”, tashmë i portretizonin atë dhe njerëzit e tij si tradhëtarë, ose një “biznesmen me të kaluar kriminale, një biznesmen në hije” duke ngritur pyetjen, pse ai ishte ende i lirë.

“Prigozhinit dhe udhëheqësve të Wagnerit duhet t’u pritët koka,” thoshte deputeti i Rosisë së Bashkuar Andrey Gurulyov, një ish-ushtar i konsideruar besnik i presidentit. Të gjithë në Rusi e dinin se Putini nuk mund të anashkalonte kurrë një gjë si ajo që kishte vuajtur para syve të gjithë botës. Nuk do i shkonte imazhit të tij si Car, si një njeri që nuk lë punë të papërfunduar, si një lider që vendos dhe që nuk bën kompromise nga frika, si ai që dukej se kishte firmosur me Prigozhinin për të ndaluar ushtrinë e tij dyqind kilometra nga Moska.

Historia e vonë e Rosisë duhet t’i kishte mësuar diçka. Por ndoshta komandanti i Wagnerit besoi tek vetja, dhe tek ajo çfarë mbeti nga lidhja e tij me Putinin. Sapo hyri në moshë, ai u arrestua për krim të organizuar, vjedhje, mashtrim dhe shfrytëzim prostitucioni të të miturve. Hyni në burg në 1982 kur Leonid Brezhnevi ishte ende gjallë, doli në vitin 1990 kur Bashkimi Sovjetik ishte në prag të kolapsit. Rusët i kujtojnë si vitet e tmerrshme vitet ‘90, por për njerëz si ai ato ishin një mundësi.

Filloi në një kioskë hot-dogësh në bashkëpunësi me një dajë. Pesë vjet më vonë, me fonde ende të panjohura, themeloi vetë kompaninë e restoranteve Concord, e cila do të mbetet gjithmonë guri i themelit të mbretërimit të tij, duke hapur një restorant ku darkonin dhe drekonin kryetari i bashkisë së Shën Petersburgut Anatoly Sobchak dhe zëvendësi i tij, një i ri me emrin Vladimir Putin. Kur ky i fundit u bë kreu i qeverisë dhe më pas president, restorantet e Prigozhinit u zgjodhën për darkat zyrtare me krerët e shteteve të huaja, që nga Zhak Shirak e deri te Xhorxh Bush.

Thuhet se Putini e ka vlerësuar



faktin që Prigozhini shpesh shërbente në tavolina personalisht. Fakti është se në vitin 2009 Concord mori kontratën për mensat shkollore të qyteteve më të mëdha ruse, dhe tre vjet më vonë atë ekskluzive për furnizimin me ushqim të Ushtrisë e Kuqe. Miliarda rubla, dhe pseudonimi “kuzhinieri i Putinit”. Në vitin 2014, gjithçka ndryshoi. Në janar, Prigozhini themeloi një agjenci kërkimore në internet në Shën Petersburgun e tij që do të bëhet më e famshme si “fabrika e trolleve”, e cila do të lejonte Kremlinin të helmonte ujërat e internetit derisa të ndikonte në zgjedhjet amerikane të vitit 2016. Në verë, gjatë pushtimit të Donbasit, i kërkoi Ministrisë së Mbrojtjes tokë për stërvitjen e “vullnetarëve” pa lidhje me ushtrinë zyrtare, por të etur për të

dhënë kontributin e tyre për atdheun kudo që ka një skenar luftime. Milicia e porsalindur do të quhet Wagner.

Është pseudonimi që i është vënë komandantit të saj të parë, Dmitry Utkin, njeriu që është konsideruar gjithmonë shpirti i grupit, ideologu që jepte shpërblime dhe ndëshkime mizore, ish oficeri i Forcave Speciale që u transferua në sektorin privat, një nazist i cili deklaroi se dy muaj më parë ishte kthyer nga një lloj pensioni për të drejtuar personalisht të ashtuquajturin Marshimi për Drejtësi.

Ndodhej edhe ai në aeroplanin që u rrëzua në zonën e Tverit. Dhe nëse vdekja e një njeriu të frikshëm, por të padashur si Prigozhini ka një vlerë të madhe simbolike në sytë e Perëndimit, ajo e Utkinit mund të ketë pasoja

më të mëdha brenda Rosisë, sepse ndër ultranacionalistët më fanatikë emri i tij ishte vërtet një legjendë.


Këto tetëmbëdhjetë muaj luftë ishin fatale për Prigozhinin. I ka jetuar gjithmonë në publik, si për të pretenduar një rol që e ndjente se i takonte. Pas vitesh mohimi se kishte lidhje me krijesën e tij, më 7 maj 2022 ai regjistroi një video në të cilën paraqitej i veshur me kamuflazhin e mercenarëve të tij. Është një kreshendo e vazhdueshme. Fillimisht ekzekutimet e drejtpërdrejta të dezertorëve, buletinet nga fronti, propaganda e bërë vetëm në emër të tij, më pas tiradat gjithnjë e më të shpeshta kundër “hajdutëve dhe burokratëve” të Ministrisë së Mbrojtjes, “fajtorë” se janë tepër të butë ndaj Kievit. Figura e tij bëhet gjithnjë e më e

rëndë.

Në fillim, pak njerëz brenda dhe jashtë vendit parashikuan një përballje kaq brutale. Për afërsinë me Putinin, dhe mbi të gjitha sepse e kemi të vështirë të pranojmë se kundërshtimi më i fortë ndaj Kremlinin ka ardhur nga ata që donin më shumë luftë, jo nga ata që donin më pak.

Por më në fund u bë e qartë se hesapet do laheshin gjithsesi. Putini kishte vendosur të shpërndante Wagnerin. Më 23 qershor, Prigozhini u nis drejt Moskës, duke sfiduar Carin e tij në publik, duke e bërë atë të duket i dobët jo vetëm në sytë e botës, por edhe të popullit të tij, gjë që është shumë më serioze dhe e pafalshme. Ajo që ndodhi mes asaj kohe dhe ditës së djeshme ka pak rëndësi. Ishte thjesht çështje kohe. / Corriere della Sera – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ballkani shkatërron BATE Borisov, një hap larg fazës së grupeve

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kampionia e Kosovës në futboll, Ballkani e ka vazhduar shkëlqimin në Ligën e Konferencës, pasi ka shënuar fitore bindëse ndaj BATE Borisov me rezultat 4-1. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" i takoi ndeshjes së parë të "play-off"-it. Ballkani e nisi më mirë ndeshje duke krijuar disa raste shënimi, por Trashi, Berisha dhe Gripshi nuk realizuan dhe rregulli i pashkruar në futboll i ndodhi Ballkanit kur nuk shënon pëson. Mysafirët në rast e parë të krijuar në minutën e dhjetë e shfrytëzuan duke realizuar nëpërmjet Laptev. Ballkani u kthye në lojë në minutën e 31-të, kur mbrojtësi shtatlartë Bajram Jashanica realizoi më kokë për rezultat 1-1. Më këtë rezultat skuadrat shkuan në pushim. Pjesa e dytë ishte plotësisht e dominuar nga Ballkani. Në minutën e 58të, pas një ndërprerje harkon Armend Thaqi dhe në zonë u gjend më së miri Tolaj që më kokë realizon për 2-1. I njëjti lojtar shënoi edhe golin e tretë pas nëntë minutave lojë.



Kampionët kosovar nuk u ndaluan me kaq pasi shënuan edhe golin e katërt dhe në këtë mënyrë iu gëzua fitores se radhës në Ligën e Konferencës dhe tash i duhet të ruaj këtë rezultat në ndeshjen kthyesë në Hungari dhe të sigurojnë kalimin në fazën e grupeve. Ballkani përveç ligës vendore vazhdon të jetë mjaftë e suksesshme edhe në garat ndërkombëtare.

Pësojnë humbje Partizani dhe Struga

Partizani pësoi humbje minimale në transfertë ndaj Astanës, në ndeshjen e parë të "play off"-it të Ligës së Konferencës. Një gol i shënuar nga Loncar në minutën e 42-të, vendosi ndeshjen. Të kuqtë ishin me fat pasi kazakëve, iu anuluan dy gola për pozicion jashtë loje. Tashmë Partizani i kërkohet një 90-minutësh perfekt në "Elbasan Arena", ku bashkë me tifozët në tribuna, do të provojë përmbysjen e madhe dhe historike. Ndërsa skuadra shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Struga e ka nisur me humbje fazën e "play-off"-it të Ligës së Konferencës. Ndeshjen e parë që u zhvillua në stadiumin e Ohrit, Struga u mposht si vendase nga skuadra islandeze, Breidablik me rezultat 0-1. Golin e vetëm në ndeshje e shënoi Hoskuldur Gunnlaugsson në minutën e 35-të. Struga ka edhe një shans ta sigurojë kualifikimin tutje në ndeshjen e kthimit që do ta luajë si mysafire në stadiumin "Kopavogsvöllur" të Islandës, më 31 shtator.



SHKURT

Kosova U17 fiton bindshëm ndaj Malit të Zi

Përfaqësuesja e Kosovës për vajza U17 në futboll ka shënuar fitore në miqësoren e dytë kundër Malit të Zi që u zhvillua sot në Rozhajë. Dardanet e reja të udhëhequra nga Sanije Krasniqi fituan me rezultat bindës 3-0. Elona Paci e zhblllokoj rezultatit në minutën e 37, kurse dy golat e tjerë i realizoi Olsa Maçastena (43', 66'). Ndeshja e parë ndërmjet këtyre dy ekipeve ishte mbyllur baras 1-1.

Rashica nga Trepça '89 kalon te Skënderbeu

Sulmuesi i talentuar i Trepçës '89, Ermir Rashica, karrierën do ta vazhdojë në Superligën e Shqipërisë te skuadra e Skënderbeut. Klubi korçar ka zyrtarizuar transferimin e Rashicës. Përpos tij, Skënderbeu ka transferuar edhe Suhel Muharremin. Rashica është zhvilluar te Trepça '89, ndërsa luajti edhe në ekipin senior në edicionin e kaluar. Ai është pjesë e Përfaqësueses së Kosovës për grupmoshat e reja. "Rashica vjen pas marrëveshjes së arritur me klubin Trepça 89, ndërsa Muharremi ka firmosur kontratën që e lidh për 3 vitet e ardhshme me klubin bardhekuq. Suksese djema!", thuhet në njoftimin e Skënderbeut.

Lëndohet Pedri, mungon katër deri gjashtë javë

Barcelona ka marrë një lajm të keq, pasi në seancën stërvitore të enjten është lënduar Pedri. Mesfushori i talentuar ka lënduar kofshën e djathtë dhe pritet të mungojë katër deri në gjashtë javë. 20-vjeçari do të humbasë disa ndeshje në La Liga si dhe ndeshjet e para në Ligën e Kampionëve.

Ancelotti konfirmon se nuk do të ketë transferime tjera, Mbappe edhe një vit në PSG

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka shpjeguar se nuk ka ndërmend ta forcojë skuadrën deri në fund të afatit kalimtar. "Jo, e përjashtoj mundësinë e përforcimeve të reja. 100 për qind është e sigurt. Ka mbaruar. Do të refuzoj çdo ofertë deri në fund të afatit kalimtar", ka deklaruar Ancelotti. Dritarja e transferimeve në botën e futbollit mbyllet të premten e 1 shtatorit në orën 11:00 dhe, sipas deklaratës së Ancelottit, Reali do ta mbajë skuadrën aktuale dhe do të hyjë me të në sezon. Emri i Kylian Mbappes ishte më i lakuar në merkaton e verës te Real Madridi, transferim, i cili, sipas të gjitha gjasave, mund të ndodhë vetëm verën e ardhshme me parametra zero.

Ballkani paraqet Manajn

Suharekë, 24 gusht - Kampioni i Kosovës, Ballkani, vazhdon të jetë aktiv në afatin kalimtar. Kampionët e kanë rikthyer në Kosovë sulmuesin Arb Manaj, i cili edicionin e fundit luajti për skuadrën e Slaven Belupos në Kroaci. "Të dashur tifozë, me kënaqësi ju

njoftojmë se skuadrës sonë kampione i bashkohet sulmuesi Arb Manaj. Futbollisti që së fundmi ishte pjesë e elitës kroate, te skuadra e Slaven Belupo, ka një eksperiencë atraktive edhe në futbollin e Turqisë. 25-vjeçarit i urojmë suksese

në arritjen e objektivave tona të përbashkëta!", thuhet në njoftimin e Ballkanit. Ish-anëtari i Trepçës '89 pritet të jetë zëvendësues i Albion Rrahmanit që u transferua në Ruman, përkatësisht në skuadrën e Rapidit të Bukureshtit.



Gega siguron finalen e 3 000 metrave me pengesa në botërorin e atletikës

BUDAPEST, 24 GUSHT - Atletja shqiptare Luiza Gega ka siguruar kualifikimin për në finalen e garës së 3 000 metrave me pengesa në botërorin që po zhvillohet në Budapest të Hungarisë. Edhe pse kampionia shqiptare mbërriti në Hungari e dëmtuar, ajo ka arritur

të bëjë një paraqitje të mirë, duke siguruar finalen. Gega garoi në baterinë e tretë të kësaj disipline, duke u klasifikuar në vendin e tretë me kohën 9'17"71. Në finale shkonin pesë vendet e para të secilës bateri (tri të tilla), ndaj Gega arriti të sigurojë

një vend për në finalen e 27 gushtit (ditën e diel). Atletja kuqezi ishte gjatë gjithë kohës mes më të mirave, duke mos e vënë në diskutim kualifikimin edhe pse jo në formën optimale. Luiza Gega do të ketë kështu tri ditë kohë për t'u

rikuperuar nga lodhja e dëmtimi, për t'u paraqitur në finale në formën më të mirë të mundshme. Gega ka siguruar prej një muaji kualifikimin për në Olimpiadën "Paris 2024", duke arritur normën olimpikë në 3 000 metra me pengesa.



Broja pritet të grumbullohet nga Chelsea për ndeshjen ndaj Lutonit

Londër, 24 gusht - Sulmuesi Armando Broja u kthye në stërvitje me ekipin e parë të Chelseat, duke firmosur autografe për një fondacion të fëmijëve me probleme, ndërsa shpreson t'u japë fund problemeve të tij. Sulmuesi i kombëtares shqiptare nuk është aktivizuar asnjë minutë deri tani këtë sezon, që i rrezikon vendin në kombëtare për ndeshjet e Evropianit, por në Angli presin që situata të ndryshojë. Mediet ishullore shkruajnë se Broja ka shumë mundësi të grumbullohet në skuadër për ndeshjen e kësaj të premteje në Premierë Ligë. Chelsea e pret Lutonin në "Stamford Bridge" dhe trajneri Mauricio Pochettino mund t'ia bëjë më në fund 21-vjeçarit dhuratën që ai e pret prej kohësh. Ndërsa ka nisur të stërvitet bashkë me shokët, Broja shpreson të ketë më shumë sesa



thjesht të jetë pjesë e bluve të Londrës, por edhe që të aktivizohet. Sulmuesi kuqezi është në garë me kohën, pasi nuk ka luajtur asnjë minutë në ndeshje zyrtare apo miqësore që kur u dëmtua dhjetorin e kaluar.

Kjo mund të bëjë që trajneri i kombëtares, Sylvinho, të mos e thërrasë në ekip për dy ndeshjet eliminatorë të Evropianit, ndaj Çekisë në Pragë më 7 shtator, dhe kundër Polonisë në "Arenën Air Albania" me datën 10.

Usyk: Luftoj për titujt dhe Ukrainën

SIMFEROPOL, 24 GUSHT - Këtë fundjavë në Poloni boksieri ukrainas Oleksandr Usyk do të mbrojë titujt kampionë bote në peshën e rëndë ndaj britanikut Daniel Dubois. Kjo sfidë është vendosur të zhvillohet në Poloni, afër Ukrainës, për shkak se kampioni i botës nuk ndeshet dot në vendlindje si pasojë e luftës. Duke folur për mediet në Ditën e Pavarësisë së Ukrainës, Usyk ka thënë: "Pas duelit me Joshuan vajta në frontin e luftës dhe qëndrova me ta. Me dylbi pashë që 900 metra larg meje ishin trupat ruse. Armiqtë tanë, tanke që shpërthenin, shtëpi që mermin flakë. Pashë njerëz pa krahë dhe pa këmbë. Pashë nga ata që dukeshin si të vdekur që ecnin në kërkim të mbijetesës. Kam parë gjithçka, edhe të vranë. Lëvizja me makinë në një qytet të vdekur, pa energji. Pashë një kënd lojërash, por asnjë fëmijë që të luante. Ushtarët nuk e



kuptonin se përse isha aty, por doja të isha me ta", ka thënë Usyk. "Ne do ta fitojmë lirinë dhe unë do të bëj maksimumin për ta ndihmuar vendin tim, sidomos në ring. Gjithçka që pashë më ka bërë më

të fortë, ndaj nuk më tremb askush, asnjë rival. As Dubois, as Fury, askush. Jam gati për t'i treguar botës kush jam, duke pasur nga pas mbështetjen e Ukrainës dhe lavdinë e saj", u shpreh Usyk.

SHKURT

Messi vazhdon shkëlqimin, Inter Miami shkon në finale

Ylli argjentinas Lionel Messi po vazhdon shkëlqimin në futbollin amerikan. Ai nuk ka shënuar në ndeshjen e fundit, por ka asistuar dy herë në fitoren që e arriti Inter Miami ndaj Cincinnati në gjysmëfinale të U.S. Open Cup. Inter Miami shkoi në finale falë fitores së regjistruar përmes penalltive (5-4), pasi koha e rregullt 90-minutëshë përfundoi me rezultat 2-2, derisa në vazhdimë secila skuadër shënoi edhe nga një gol (3-3). Kështu Messi me shokë do ta kërkojnë trofeun e dytë në histori brenda vetëm pak javësh. Në finalen e madhe të kësaj gare, Inter Miami do të luajë me Houston Dynamon në "DRV PNK Stadium" më 27 shtator.

Legjenda gjermane: Neymari është fals dhe i neveritshëm

Transferimi i Neymarit nga PSG-ja tek Al Hilali vazhdon të jetë një element diskutimi jo vetëm për angazhimin faraonik të brazilianit, i shoqëruar edhe me një sërë shpërblimesh të çuditshme si shofer gjithmonë në dispozicion, garazh supermakinash dhe një vilë të madhe. Shumë janë të trishtuar kur shohin një tjetër yll botëror larg Evropës, por ka nga ata që janë "mbi hënë" për shitjen e brazilianit. Ky është rasti i Paul Breitnerit, një legjendë e futbollit gjerman, i cili foli në mikrofonat e rrjetit gjerman BR në mënyrë të prerë ndaj ish-sulmuesit të PSG-së: "Faleminderit të dashur sauditë që e bletë Neymarin! Një nga futbollistët të neveritshëm dhe fals nën diellin e viteve të fundit. Një nga ata që bëjnë vetëm teatër, që synon vetëm të shtrihet në fushë. E tmerrshme. Neymari është një bakter, një mikrob mashtrues. Fatmirësisht, nuk kam pse ta duroj më atë".

Ancelotti favorizon Juven në garë për 'Scudetto'

Carlo Ancelotti në një intervistë për "Storie di Serie A" në Radio Serie A me RDS ka folur edhe për luftën për "Scudetto" të sezonit 2023/24. Trajneri aktual i Real Madridit që ka drejtuar shumë klube italiane ka thënë se Juventus është favorit në garën për titull. "Titulli? Nuk e di. Mendoj se janë katër skuadra favorite: Napoli, Milani, Interi dhe Juventus. Më pas ka një grup skuadrash që do të kërkojë të mbajë ritmin si Roma, Lazio dhe Atalanta. Edhe Fiorentina që mund të bëjë një kampionat të bukur. Besoj se këtë vit Juventus, duke parë se nuk do të luajë në Evropë, do të jetë i rrezikshëm. Në nivel profesional, të heq diçka të mos luash në Ligën e Kampionëve. Në nivel të përgjithshëm, Juventus mund të bëjë një sezon pozitiv pikërisht për këtë. Një gjë është të përgatisësh një ndeshje në tri ditë dhe një tjetër në një javë", ka thënë Ancelotti.

Mançini pritet të emërohet trajner i Arabisë Saudite

Roberto Mançini duket se nuk do të rrijë gjatë pa punë. Trajneri italian ka arritur marrëveshje me Federatën e Futbollit të Arabisë Saudite për ta drejtuar këtë Kombëtare në vitet në vazhdim. Mediet italiane i kanë zbuluar edhe detajet e marrëveshjes, ndërsa janë të bindura se oferta stratosferike e arritur nga sauditët po del që ka qenë arsyeja e vendimit të tij për të dhënë dorëheqje nga Kombëtarja e Italisë. Pra, mediet italiane e kanë thumbuar trajnerin, duke shkruar se "Arabia Saudite paska qenë arsyeja personale e dorëheqjes...". Mançini do të shkojë në Lindjen e Mesme me stafin e tij historik, ndërsa pritet të nënshkruajë kontratë deri në vitin 2026. Ish-trajneri i Interit në këtë periudhë trevjeçare do të paguhet plot 90 milionë euro.

Al Ittihadi 'frikëson' Kloppin dhe Liverpoolin, kjo është oferta për Salahun

Me fonde pa limit, Arabia Saudite po tundon çdo lojtar apo trajner. Së fundmi, sheikët i janë vënë pas sulmuesit të Liverpoolit, Mohamed Salah. Al Ittihadi kërkon të formojë një

dyshe ëndrrash për këtë sezon të ri Benzema-Salah. Klubi saudit ka gati një ofertë marramendëse për të bindur "The Reds", por dhe lojtarin. Sipas medieve angleze: Al Ittihadi i ofron Liverpoolit 100

milione euro për kartonin e egiptianit, ndërsa për Salahun kanë gati një ofertë trevjeçare dhe 100 milionë euro në vit. Jurgen Kloppi e konsideron "faraonin" të paprekshëm, pika

kryesore e projektit të tij, por përballë një shifre të tillë, si drejtuesit e klubit ashtu edhe vetë lojtari janë të gatshëm të futen në negociatë. Problemi është se Liverpooli e gjen veten të

papërgatitur përballë një situatë të tillë. Duhet të lëvizë shpejt për të gjetur një zëvendësues. Ka kohë deri më 31 gusht. Opsioni i parë është Johan Bakayoko, sulmuesi belg 20-vjeçar i PSV-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 164 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 06/L-016, nenit 5 paragrafi 5, nenit 16 dhe 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III/nr. 31/15 qershor 2008), dhe plotësim ndryshimeve përkatëse me Ligjin nr. 04/L-111 dhe nr. 05/L-009, dhe në pajtim me normat tjera pozitive relevante, nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, nenit 13 të Statutit të NPK "Trafiku Urban" SHA. nr.1173 dt.05.04.2023 dhe vendimit nr. 2994 të datës 22.08.2023 Komisioni Komunal i Aksionarëve të NPK "TRAFIKU URBAN" SHA. në Prishtinë, me datën 22.08.2023 shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Pozitat: Drejtor të Bordit Drejtues të N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A. Prishtinë.

Numri i Pozitave: 4 (katër)

I përgjigjen: Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A. Prishtinë.

Mandati: 3 (tre) vite.

Kompensimi: Konform nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, dhe plotësim ndryshimeve përkatëse.

1. Të përgjithshme

Kandidati/ja për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili/e cila i plotëson kushtet e kualifikimit dhe kriteret e pavarësisë, posedon përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, si dhe i plotëson kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera pozitive relevante.

2. Kushtet e kualifikimit profesional dhe përshtatshmërisë

Çdo kandidat për t'u konsideruar në pozitën e Drejtorit të Bordit, duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë - së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushat si vijon: në administrim të biznesit; - financa të korporatave; - financa; - menaxhim thesari; - banka; - konsulencë në biznes ose industri; ose - nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë, e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste - të ndërmarrjes; ose për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar- i kualifikuar i një profesioni tjetër, i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

3. Papajtueshmëria

Konform ligjit në fuqi, një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjeve publike, nëse:

- Ka qenë i/e dënuar nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës; ka kryer vepër penale ose civile, vepër që përfshinë përgënjeshtrimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve; ka qenë i/e përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare;
- është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keqpërvetësuar apo ka keqpërdorur paratë apo burimet publike, (iv) se ka keqpërdorur apo keqpërvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo;
- ka bërë përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar; dhe
- është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara;
- punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

3.1 Të gjithë drejtorët duhet të jenë të pavarur. Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

- aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara;
- aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;
- aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç; si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç; honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të ligjit primar, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj;
- mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;
- përfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;
- është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurron me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të llastuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen; dhe
- është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktojnë që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

4. Dokumentacioni i nevojshëm.

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Drejtorëve, konform këtij konkursi, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Aplikacionin (merret në zyrën e ndërmarrjes ose në web faqe të ndërmarrjes,) www.trafikurban-pr.com
- CV-në e detajuar
- Letër motivim
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional të noterizuar (Diplomat/Certifikatat dhe dokumente të ngjashme të marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara).
- Dëshmitë mbi përvojën e punës e vërtetuar me trustin pensional (Aplikacioni duhet të ofroj të dhëna të sakta mbi periudhat e angazhimit dhe të korrespondojë me dokumentet vërtetuese).
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo me e vjetër se tre muaj)
- Deklaratën nën betim (merret në zyrat e ndërmarrjes, ose në ueb faqe të ndërmarrjes).

Me këtë dokument kandidati deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe bpublike nr. 03/L-087. **Çdo përgënjeshtrim material - qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca - ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.**

• Kopjen e letërnjoftimit ose Pasaporta

• Lista kontrolluese (merret në zyrën e ndërmarrjes, ose në ueb faqe të ndërmarrjes).

5. Informata për procedurën e konkurrimit.

Konkursi publik do të jetë i hapur 30 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor prej datës **01.09.2023** deri më datën **30.09.2023**. Dokumentacioni i aplikantëve mund të dorëzohet në arkivin e N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A. në Prishtinë, çdo dite pune prej orës 8:00 - 16:00 në zarf të mbyllur, ose përmes postës, duke e adresuar për Komisionin Komunal të Aksionarëve të N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A. Rr. Tahir Zajmi - 10000 në Prishtinë – me titullin "Aplikacion për Drejtor Bordi".

Të gjitha dokumentet të paraqiten në kopje të noterizuara, ndërsa origjinali i tyre, do të kërkohet në fazat e më vonshme të përzgjedhjes. Informatat shtesë mund të sigurohen përmes e-mail adresës: info@trafikurban-pr.com ose drejtpërdrejtë në arkivin e Ndërmarrjes. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren parasysh. Të gjithë formularët duhet plotësuar në tërësi, mos plotësimi i tyre dhe informatat e pasakta do të rezultojnë në diskualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

Komisioni Komunal i Aksionarëve do të zhvillojë një procedurë të hapur /transparente dhe konkurruese, ku përzgjedhja do të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës, konform Ligjeve në fuqi dhe pa asnjë lloj diskriminimi, për çka inkurajon në aplikim kandidatët:

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta punësimi, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike NPK "Trafiku Urban" Sh.A, Prishtinë



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LĒKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 12-23

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtarëve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në **adresën Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

Dosja për: Kontrat për përkthim dhe lekturim të dokumenteve të OMK-së

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **06.09.2023 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **08.09.2023 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **08.09.2023 ora 14:00.**



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Priština



Na osnovu člana 164 Zakona o privrednim društvima 06/L-016, člana 5 stav 5, člana 16 i 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 (Službeni list Republike Kosovo/Priština: godina III/br. 31/15. jun 2008), i dopunjavanje relevantne izmene Zakonom br. 04/L-111 i br. 05/L-009, au skladu sa drugim relevantnim pozitivnim normama, član 20. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, član 13 Statuta NPK „Trafiku Urban“ SHA. broj 1173 od 05.04.2023. godine i rešenje broj 2994 godine od 22.08.2023. godine Opštinska komisija akcionara NPK „TRAFIKU URBAN“ SHA. u Prištini, dana 22.08.2023. saopštava:

JAVNI KONKURS

Funkcije: Funkcije Upravnog Odbora NPK „Trafiku Urban“ SHA. Priština.

Broj pozicija: 4 (četiri)

Odgovara: Opštinskoj Komisiji Akcionara NPK „Trafiku Urban“ SHA. Priština.

Mandat: 3 (tri) godine.

Naknada: U skladu sa članom 20. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, i dovršiti relevantne izmene.

1. Generalno

Kandidati za ovu poziciju moraju biti lice od integriteta, koje ispunjava kvalifikacione uslove i kriterijume nezavisnosti, da poseduje potrebne stručno iskustvo i traženu stručnu spremu, kao i da ispunjava druge uslove propisane odredbama Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća i druga relevantna pozitivna akta.

2. Uslovi stručne spreme i podobnosti

Svaki kandidat koji se razmatraju za poziciju direktora odbora moraju imati najmanje pet (5) godina iskustva - najmanje na visokom nivou menadžmenta u sledećim oblastima: u poslovnoj administraciji; korporativne finansije; - finansije; - upravljanje trezorom; - banka; - konsultantske usluge u poslovanju ili industriji; ili iz druge oblasti nauke ili znanja, koja je u vezi sa poslovnim delatnošću - preduzeća; ili najmanje pet (5) godina da je bio javni računovođa, kvalifikovani pravnik ili kvalifikovani član druge profesije koja je usko povezana sa poslovnim delatnošću JP.

3. Nekompatibilnost

Prema važećem zakonu, lice nema pravo da bude direktor u odboru javnih preduzeća, ako:

- je izrečena kazna od nadležnog suda, osim ako je ovu kaznu ili odluku naknadno preinačio drugi sud na osnovu žalbe; je počinio krivično ili građansko delo, krivično delo koje uključuje falsifikovanje, lažno predstavljanje, korupciju, krađu, pranje novca, proneveru, proneveru ili lažnu raspodelu sredstava; je bio umešan u podmičivanje ili podmičivanje u skladu sa zakonima ili propisima koji su na snazi na Kosovu ili bilo kojoj drugoj zemlji, ili prema međunarodnim ugovorima ili konvencijama;
- ako je odlučio sud ili telo ili organizacija odgovorna za primenu etičkog kodeksa ili standarda profesionalnog ponašanja, osim ako ovu kaznu ili odluku naknadno ne promeni drugi sud ili telo na osnovu pritužbe (i) da je angažovan u neprofesionalnom ponašanju, (ii) da je prekršio etički kodeks ili standarde profesionalnog ponašanja, (iii) da je prisvojio ili zloupotrebio novac ili javna sredstva, (iv) da je zloupotrebio ili prisvojio informacije (podatke). zarađen tokom službe kao javni službenik ili državni službenik, ili (v) da je zloupotrebio javnu funkciju ili položaj u državnoj službi za ličnu korist ili za korist ili korist rođaka ili poznanika; ili;
- je dao materijalne demantije pod bilo kojim svedočenjem pod zakletvom ili drugom zakletvom, ili zapečaćenom ili overenom ispravom; i
- je proglašen bankrotom u poslednjih deset (10) godina;
- radi u bilo kojoj instituciji u kojoj se kreiraju razvojne politike za relevantno Javno preduzeće u kojem kandidat radi.

3.1 Svi direktori moraju biti nezavisni. Lice se ne smatra nezavisnim i ne može biti izabrano za direktora u JP ako:

- je trenutno službenik ili menadžer relevantnog JP ili bilo koje njegove podružnice, ili je služio kao službenik ili menadžer relevantnog JP ili bilo koje njegove podružnice u proteklih pet (5) godina;
- je trenutno zaposleni na visokom nivou u relevantnom JP, ili je radio kao zaposleni na visokom nivou u relevantnom JP u poslednje tri (3) godine;
- ima trenutno, ili tokom poslednje tri godine, bilo kakve materijalne poslovne odnose (osim; kao pojedinačni potrošač usluga JP) sa relevantnim JP ili bilo kojim od njegovih podružnica, bilo direktno ili indirektno poprečno;
- je akcionar, direktor, funkcioner ili viši službenik u privrednom društvu ili drugom pravnom licu koje ima materijalni poslovni odnos sa relevantnim NP ili bilo kojim od njegovih zavisnih preduzeća;
- je prihvata, ili je prihvatio u protekle tri (3) godine, dodatnu nadoknadu od relevantnog JP ili bilo kog od njegovih filijala (osim; honorar direktora ili podsticajna naknada definisana u članu 20.1 primarnog zakona, ili je član šemu penzije relevantnog JP ili bilo koje njegove podružnice;
- ima zajedničke direktorske funkcije ili ima značajne veze sa drugim direktorima relevantnog JP kroz učešće u drugim privrednim društvima ili telima;
- predstavlja akcionara koji poseduje deset procenata (10%) akcija sa pravom glasa u relevantnom JP;
- je ili (i) zaposleni, službenik, direktor ili akcionar, ili ima finansijski interes u komercijalnoj kompaniji koja nije kotirana na berzi koja se takmiči sa Preduzećem, ili (ii) viši menadžer, službenik, direktor ili akcionar (i koji poseduje više od dva procenta (2%) glasačkih prava, ili ima značajan finansijski interes u bilo kojoj od razmaženih komercijalnih kompanija koje se takmiče sa Preduzećem; I
- je ili je u bilo kom trenutku tokom perioda od 36 meseci pre datuma podnošenja zahteva bio (i) izabrani javni zvaničnik, (ii) politički imenovani ili (iii) nosilac rukovodstva ili pozicije na kojoj se donose odluke u politička partija;
- ima bilo kakav sukob interesa koji bi, po svojoj prirodi, doveo do toga da ovo lice ne bude u stanju da rutinski, verno, nezavisno i objektivno ispunjava svoje fiducijarne obaveze prema Akcionarima i JP-u.

4. Potrebna dokumentacija.

Kandidati za direktore u Upravnom odboru, u skladu sa ovim konkursom, moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Prijava (primljena u kancelariji kompanije ili na sajtu kompanije) www.trafikurban-pr.com
 - Detaljan CV
 - Motivaciono pismo
 - Dokaz o stručnoj kvalifikaciji kod javnog beležnika (Diplome/Sertifikati i slični dokumenti dobijeni u inostranstvu moraju biti overeni kod notara).
 - Dokaz o radnom iskustvu overen kod penzijskog fonda (u aplikaciji moraju biti navedeni tačni podaci o periodima angažovanja i da odgovara pratećoj dokumentaciji).
 - Uverenje koje nije pod istragom (ne starije od tri meseca)
 - Izjava pod zakletvom (dobija se u kancelarijama kompanije, ili na sajtu kompanije).
- Ovim dokumentom kandidat izjavljuje da ispunjava uslove kvalifikacije, nezavisnosti i profesionalne podobnosti iz st. 1-3 člana 17. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087. **Svaki materijalni falsifikovanje – bilo namerno ili iz nemara – ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi će dovesti do momentalne diskvalifikacije osobe i, ako je primenljivo, uklanjanja.**
- Kopija lične karte ili pasoša
 - Kontrolna lista (dostupna u kancelariji preduzeća ili na veb stranici preduzeća).

5. Informacija o konkursnoj proceduri.

Javni konkurs će biti otvoren 30 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi od **01.09.2023** godine do **30.09.2023** godine. Dokumentaciju podnosioca prijave potrebno je dostaviti u arhivu N.P.K. “TRAFIKU URBAN” SHA. u Prištini, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova u zatvorenoj kovrti, ili poštom, obračunajući se Opštinskoj komisiji akcionara N.P.K. “TRAFIKU URBAN” SH.A. Rr. Tahir Zajmi - 10000 u Prištini – sa titulom „Prijava za direktora odbora“.

Svi dokumenti moraju biti dostavljeni u overenim kopijama, dok će njihovi originali biti potrebni u kasnijim fazama selekcije. Dodatne informacije mogu se dobiti putem e-mail adrese: info@trafikurban-pr.com ili direktno u arhivi Kompanije. Prijave dostavljene nakon roka i nepotpune neće se razmatrati. Svi obrasci moraju biti popunjeni u celini, nepopunjavanje i netačne informacije će dovesti do momentalne diskvalifikacije i, ako je primenljivo, uklanjanja osobe.

Opštinska komisija akcionara će razviti otvorenu/transparentnu i konkurentnu proceduru, gde će se izbor vršiti isključivo na osnovu zasluga, u skladu sa važećim zakonima i bez ikakve diskriminacije, za šta podstiče kandidate da se prijave:

Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

Kompanija nudi jednake mogućnosti zapošljavanja, podstiče i promoviše angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Opštinska Komisija Akcionara Javnog Preduzeća NPK “Trafiku Urban” SHA Priština.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimin e Bordit të datës 25.06.2020 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 25.08.2023 të rishpallë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Inkasant/e - Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/njëvjeçare), me mundësi vazhdimi

Numri i referencës: 06-23-34/1

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Bënë inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materialisht
- Bënë zbulimin – regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara
- Përcjellë ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke njoftuar shërbimin e faturimit
- Dorëzimin ditor të pazarit nga faturat e inkasuara
- Përgjegjësi materiale dhe penale për faturat e inkasuara si dhe përgjegjësi në punë
- Realizimi i normativit të inkasimit i përcaktuar sipas planit të punëdhënësit
- Kryen edhe punë tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit drejtpërdrejtë

Kualifikimet e kërkuesit:

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme ;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjekësore (me rastin e lidhjes së kontratës);

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave “Uniteti” Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 25.08.2023 deri më datën 08.09.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Dream Photography" SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Arbresha Dërmaku Limani, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811554684 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Dream Photography" D.O.O. Gnjilane, sa vllasnikom Arbresha Dërmaku Limani, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 811554684 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Dream Photography" L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Arbresha Dërmaku Limani, has come to the decision to quit its business: 811554684 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Elsa Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Emin Duraku", Gjakovë.

- Ordinanca Ana Dental Care, Fushë Kosovë shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit.

- Burbuqe Temaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të I- të Gjimnazit "Hajar Dushi" Gjakovë.

- Ismet Tahiraj, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani", ish-shkollës "Brois Kidriç".

- N.P.SH BEST WEY, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 811333880, "Bekim Shkreli B.I".

- N.P.SH BEST WEY, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NR: 330433954, "Bekim Shkreli B.I".

- Driton Hajrizi, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Albina Bucolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-9 të shkollës "Fazli Grajqevci" Poklek Vasilev komuna e Drenasit.

- Alban Bucolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-9 të shkollës "Fazli Grajqevci" Poklek Vasilev komuna e Drenasit.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

